



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINSTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. _____ prot.

Dt. 28.02.2019

MEMORANDUM MIRËKUPtimi MBI FUNKSIONIMIN E RRJETIT TË
QENDRAVE TË TË NXËNIT GJATË GJITHË JETËS TË NGRITURA NË TETË
UNIVERSITETE SHQIPTARE

NDËRMJET

UNIVERSITETIT TË SPORTEVE, TIRANË
UNIVERSITETIT “LUIGJ GURAKUQI” SHKODËR
UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS
UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN
UNIVERSITETIT “FAN.S.NOLI”, KORÇË
UNIVERSITETIT “EQEREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR
UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI”, VLORE
SHPAL”PAVARËSIA”, VLORE
INSTITUTIT TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Kurrikula e bazuar në kompetenca, e cila po zbatohet në të gjithë sistemin e arsimit parauniversitar që prej vitit 2014, kërkon ndryshim përsa i përket procesit të të nxënësve, vlerësimit të nxënësve, gjithëpërfshirjes, përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie etj. Ndryshimi në praktikë që duhet të bëjnë mësuesit, kërkon përgatitje më të gjerë për mësimin, si dhe një vëzhgim më nga afër se çfarë është në gjendje të bëjë një nxënës. Gjithashtu, kurrikula e re i kërkon mësuesit të vendosë nëse nxënësi ka demonstruar disa nga kompetencat dhe të përshtatë strategjitë e të mësuarit për të përmirësuar performancën e nxënësit. Procesi i zbatimit fokusohet në arritjet e këtyre ndryshimeve në praktikën e mësuesit nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë në Shqipëri. Ky proces realizohet brenda periudhës kohore që mësuesit janë në punë duke shfrytëzuar periudhat që nuk zhvillohet mësim.

Bazuar në projektin “Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve në Shqipëri” (TEAVET) (ERASMUS+) dhe pikërisht në pikën 2.4. “Për krijimin e rrjetit të qendrave të të nxënësve gjatë gjithë jetës për trajnimin e mësuesve”, në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 69/2012 datë 21.06.2012 “Për arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; në Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020, Udhëzim nr.1, datë 20.01.2017, “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”; në Standardet profesionale të mësuesit, të të universitetit e përfshira në këtë projekt Universiteti i Sporteve, Tiranë, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë, Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, Shpall “Pavarësia”, Vlorë dhe Instituti i Zhvillimit të Arsimit, të cilat përgatisin dhe zbatojnë politikën e zhvillimit profesional të mësuesve në fushat e aktivitetit të tyre, kanë rënë dakord mbi termat dhe kushtet si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është koordinimi ndër-institucional për zhvillimin profesional të mësuesve në sistemin e arsimit parauniversitar, nëpërmjet realizimit të trajnimeve të mësuesve sipas moduleve të akredituara nga Komisioni i akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit (KAPT), në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Trajnimeve në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Neni 2

Objektivat

Objektivat kryesorë të Memorandumit janë:

- a) Hartimi i moduleve të trajnimit në përputhje me nevojat dhe kërkesat e

mësuesve në arsimin parauniversitar të identifikkuara në kuadër të këtij projekti;

- b) Akreditimi i moduleve të trajnimit të hartuara nga institucionet e arsimit të lartë të përfshira në këtë projekt;
- c) Ofrimi i trajnimeve të mësuesve të arsimit parauniversitar nga qendrat e trajnimit të të nxënit gjatë gjithë jetës të ngritura pranë institucioneve të arsimit të lartë të përfshira në këtë projekt.

Neni 3

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Marrëveshja hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj datë 28.02.2019deri nëpërfundim të projektit TEAVET(Erasmus +), Tetor 2020 dhe do të zbatohet në qendrat e të nxënit gjatë gjithë jetës për trajnimin e mësuesve nëinstitucionet: Universiteti i Sporteve, Tiranë, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë, Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, Shpal”Pavarësia”, Vlorë.

Neni 4

Përgjegjësitë e institucioneve

4.1 Institucionet e arsimit të lartë

Institucionet e arsimit të lartë marrin përsipër:

- të sigurojnë funksionimin e rrjetit të qendrave të të nxënit gjatë gjithë jetës për trajnimin e mësuesve;
- të hartojnë module trajnimi sipas fushave në përputhje me nevojat e mësuesve;
- të sigurojnë trajnime të mësuesve në arsimin parauniversitar në përputhje me nevoja dhe interesat e mësuesve dhe moduleve të trajnimit të akreditimit;
- të koordinojnë funksionimin e rrjetit të qendrave të të nxënit gjatë gjithë jetës për trajnimin e mësuesve ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, bazuar në udhëzuesin për qendrat e të nxënit gjatë gjithë jetës;
- të zbatojnëlegjislacionin përkatës për organizimin e trajnimeve të mësuesve;
- të vënë në dispozicion mjediset e qendrave të të nxënit gjatë gjithë jetës për trajnimin e mësuesve;
- të certifikojnë mësuesit në përfundim të trajnimeve për modulet e trajnimit të akredituara.

4.2Instituti i Zhvillimit të Arsimit

Instituti i Zhvillimit të Arsimit merr përsipër:

- të mbështesë institucionet e arsimit të lartë të përfshira në projektin TEAVET për funksionimin e rrjetit të qendrave të të nxëniet gjatë gjithë jetës për trajnimin e mësuesve;
- të mbështesë institucionet e arsimit të lartë të përfshira në projektin TEAVET për akreditimin e moduleve të trajnimit të hartuara në kuadër të këtij projekti;
- të sigurojnë regjistrimin e institucioneve të arsimit lartë në portalin e trajnimeve të mësuesve;
- të mbështesë institucionet e arsimit të lartë me materialet e zbatimit të kurrikulës si dhe me materiale të tjera të hartuara nga IZHA për zhvillimin profesional të mësuesve.

Neni 5

Përfaqësimi i institucioneve

Institucionet nënshkruese të këtij Memorandumi vendosin që Memorandumi të mbikqyret nga drejtuesit e institucionevetë përcaktuara si më poshtë:

- Universiteti i Sporteve, Tiranë, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Universiteti “Fan. S. Noli”, Korçë, Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, Shpallim “Pavarësia”, Vlorë (*Rektorët përkatës*);
- Instituti i Zhvillimit të Arsimit (*Drejtori i përgjithshëm*).

Neni 6

Dispozita përfundimtare

Institucionet kanë të drejtë të negociojnë ndryshime ose amendamente të elementëve të këtij Memorandumi. Ky Memorandum mund të ndryshohet nga institucionet vetëm me shkrim.

Nëse pas datës së nënshkrimit të këtij Memorandum miratohen akte ligjore/nënligjore që ndryshojnë ose ndikojnë në kushtet e këtij Memorandumi, ato do të jenë objekt i shtesave/amendimeve me shkrim për atë që institucionet ndikohen në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas këtij Memorandumi.

Ky Memorandum është nënshkruar sot në datë ___ / ___ / 2019, në 9 kopje të barasvlershme.

Institutionetpartnere	Përfaqësues legal	Firma	Vula
Universiteti i Sporteve, Tiranë	Rektori: Prof. Dr. Agron Çuka		
Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	Rektori: Prof. Dr. Adem Bekteshi.		
Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës	Rektori: Prof. Dr. Kseanela Sotirovski		
Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan	Rektori: Prof. Dr. Skender Topi		
Universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë	Rektori: Prof. Dr. Ali Jashari		
Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastrër	Rektori: Prof. Dr. Bektash Mema		
Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë	Rektori: Prof. Dr. Roland Zisi		
Shpall “Pavarësia”, Vlorë	Rektori: Prof. Dr. Luan Gjonçe		
Instituti i Zhvillimit të Arsimit	Drejtori: Gerti Janaqi		